



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

30 Dhjetor, 2025

Nr. 01 Prot.

Drejtuar: Znj. Delina Ibrahimaj
Ministër
Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Për dijeni: Z. Engjëll Agaçi
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

E nderuar Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit,

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham), në kuadër të procesit të konsultimit publik për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullores mbi procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte që lidhen me ose ndikojnë në infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me inpute kritike, aksesin në informacion të ndjeshëm apo mbi lirinë e medias”*, dëshiron të paraqesë komentet dhe sugjerimet e saj.

AmCham vlerëson rëndësinë strategjike të mekanizmit të *“Foreign Direct Investment Screening (FDI Screening)”* si një instrument i domosdoshëm për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, duke ruajtur njëkohësisht një klimë të qëndrueshme, të parashikueshme dhe nxitëse për investimet e huaja direkte, të cilat përbëjnë një motor kyç të zhvillimit ekonomik të vendit. Në këtë kuptim, nisma për krijimin e një mekanizmi kombëtar të shqyrtimit të investimeve përbën një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit ligjor shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/452.

Megjithatë, nga analiza juridike dhe institucionale e projektvendimit rezulton se, në formën aktuale, ai paraqet një sërë problematikash thelbësore, të cilat rrezikojnë të krijojnë pasiguri juridike, të cenojnë parimin e proporcionalitetit dhe të dekurajojnë investitorët e huaj seriozë.

1. Niveli normativ i aktit

Procesi i shqyrtimit të investimeve të huaja është kompleks, delikat dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e investorëve dhe në ekonominë kombëtare. Në këtë kontekst, AmCham vlerëson se miratimi i një rregulloreje me Vendim të Këshillit të Ministrave nuk përbën një bazë të mjaftueshme ligjore. Një mekanizëm i tillë kërkon një ligj të posaçëm, i cili të adresojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të gjitha elementet e procesit të “screening”, duke reduktuar hapësirat për interpretime subjektive dhe qasje të paunifikuara.

2. Pajtueshmëria me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe procesin e negociatave

Edhe pse drafti pasqyron në plan formal strukturën e Rregullores (BE) 2019/452, ai nuk reflekton plotësisht dimensionin interpretues dhe balancues të Recital-eve të saj, të cilat janë thelbësore për një zbatim proporcional, të arsyetuar dhe të parashikueshëm të mekanizmit. Një akt nënligjor i fragmentuar rrezikon të mos sigurojë një konvergjencë reale me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane, veçanërisht në kontekstin e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

3. Qartësia, transparenca dhe siguria juridike

Në formën aktuale, projektvendimi paraqitet i paqartë në tërësinë e tij dhe nuk garanton transparencë të mjaftueshme në procesin e shqyrtimit të investimeve. Përdorimi i terminologjisë së përgjithshme dhe të paqartë, si p.sh. “vlerësim siç duhet”, krijon hapësirë për interpretime të ndryshme dhe potencialisht për trajtim subjektiv të kërkesave për investim.

Kriteret e vlerësimit të riskut duhet të jenë të përcaktuara qartë, objektive dhe të parashikueshme, në mënyrë që investitori i huaj të ketë siguri juridike dhe të mund të vlerësojë në mënyrë të informuar rrezikun rregullator.

4. Arkitektura institucionale e vendimmarrjes

Një risk i rëndësishëm lidhet me arkitekturën institucionale të vendimmarrjes. Drafti përqendron kompetenca shumë të gjera në një Komitet Ndërmnistror, pa parashikuar rregulla të detajuara për funksionimin e tij, përfshirë kuorumin, mënyrën e votimit dhe trajtimin e konflikteve të interesit. Kjo mungesë e rregullimit procedural krijon hapësirë për vendimmarrje diskrecionale dhe vështirëson mbrojtjen juridike të vendimeve.

5. Afatet procedurale dhe proporcionaliteti

Afati 5-ditor për plotësimin e dokumentacionit nga investitori i huaj, me pasojë anulimin e procedurës në rast mosrespektimi, konsiderohet joproporcional. Po ashtu, parashikimi i miratimit automatik të investimit në mungesë të një vendimi brenda afatit e lidh rezultatit e procedurës me rrjedhën formale të afateve dhe jo me vlerësimin substancial të rrezikut, duke krijuar dobësi strukturore në mekanizëm.

6. Qasja procedurale ndaj investitorit të huaj

Parashikimi i "thirrjes së investitorit të huaj në seancë dëgjimore" krijon perceptimin e një procedure hetimore ose ndëshkuese, e cila nuk është në përputhje me frymën nxitëse dhe mikpritëse që duhet të karakterizojë kuadrin ligjor për investimet e huaja.

7. Nevoja për një qasje të re: Ligj i posaçëm për FDI Screening

Në këtë kontekst, AmCham vlerëson se projektvendimi aktual duhet të ripunohet në tërësinë e tij dhe sugjeron hartimin e një ligji të posaçëm për shqyrtimin e investimeve të huaja, i cili të adresojë në mënyrë të qartë dhe koherente, ndër të tjera: fushat dhe sektorët subjekt të shqyrtimit; profilin dhe origjinën e investitorëve; pragjet e investimeve; kriteret e vlerësimit të riskut; strukturën institucionale; procedurat dhe garancitë procedurale; sanksionet; si dhe përputhshmërinë e plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

AmCham shpreh gatishmërinë e plotë për të kontribuar me ekspertizë profesionale në hartimin e një kuadri ligjor të qëndrueshëm dhe të balancuar, si dhe për bashkëpunim me institucionet kompetente në përgatitjen e një dokumenti orientues për ligjin e ardhshëm mbi shqyrtimin e investimeve të huaja.

Duke ju falënderuar, mbetemi në dispozicion për çdo diskutim të mëtejshëm teknik ose institucional.

Me respekt,

Dhoma Amerikane e Tregtisë

Dear Minister of Economy and Innovation,

The American Chamber of Commerce in Albania (AmCham), within the framework of the public consultation process on the Draft Decision of the Council of Ministers *“On the approval of the regulation on procedures for the assessment and screening of foreign direct investments that are related to or have an impact on critical public infrastructure, critical technologies and dual-use items, the supply of critical inputs, access to sensitive information, or media freedom,”* hereby submits its comments and recommendations.

AmCham recognizes the strategic importance of the Foreign Direct Investment Screening (FDI Screening) mechanism as a necessary instrument for safeguarding national security and public order, while at the same time preserving a stable, predictable, and investment-friendly environment for foreign direct investments, which constitute a key driver of the country’s economic development. In this regard, the initiative to establish a national investment screening mechanism represents an important step toward aligning the Albanian legal framework with the European Union *acquis*, in accordance with Regulation (EU) 2019/452.

However, based on the legal and institutional analysis of the draft decision, it appears that, in its current form, it presents a number of fundamental shortcomings, which risk creating legal uncertainty, undermining the principle of proportionality, and discouraging serious foreign investors.

1. Normative level of the act

The process of screening foreign direct investments is complex, sensitive, and has a direct impact on investors’ rights and the national economy. In this context, AmCham considers that the adoption of such a regulation through a Decision of the Council of Ministers does not constitute a sufficient legal basis. Such a mechanism requires a dedicated law that comprehensively and sustainably addresses all elements of the screening process, thereby reducing the scope for subjective interpretations and non-uniform approaches.

2. Compliance with European Union legislation and the accession negotiation process

Although the draft formally reflects the structure of Regulation (EU) 2019/452, it does not fully incorporate the interpretative and balancing dimension of its Recitals, which are essential for ensuring a proportional, reasoned, and predictable application of the mechanism. A fragmented secondary legal act risks failing to ensure genuine convergence with European standards and best practices, particularly in the context of Albania’s accession negotiations with the European Union.

3. Clarity, transparency, and legal certainty

In its current form, the draft decision lacks overall clarity and does not guarantee sufficient transparency in the investment screening process. The use of broad and vague terminology, such as “due assessment,” creates room for divergent interpretations and potentially subjective treatment of investment applications.

Risk assessment criteria should be clearly defined, objective, and predictable, in order to provide foreign investors with legal certainty and enable them to make an informed assessment of regulatory risk.

4. Institutional decision-making architecture

A significant risk arises from the institutional architecture of decision-making. The draft concentrates extensive powers within an Interministerial Committee, without providing detailed rules on its functioning, including quorum requirements, voting procedures, and the management of conflicts of interest. This lack of procedural regulation creates space for discretionary decision-making and complicates the legal protection of decisions.

5. Procedural deadlines and proportionality

The five-day deadline imposed on foreign investors to complete documentation, with the consequence of annulment of the procedure in case of non-compliance, is considered disproportionate. Furthermore, the provision for automatic approval of an investment in the absence of a decision within the prescribed deadline links the outcome of the procedure to the formal lapse of time rather than to a substantive risk assessment, thereby creating structural weaknesses in the mechanism.

6. Procedural approach toward foreign investors

The provision for summoning the foreign investor to a hearing session creates the perception of an investigative or punitive procedure, which is not in line with the facilitative and welcoming spirit that should characterize the legal framework governing foreign investments.

7. The need for a new approach: a dedicated law on FDI Screening

In this context, AmCham considers that the current draft decision should be comprehensively revised and recommends the drafting of a dedicated law on the screening of foreign investments, which would clearly and coherently address, inter alia: the scope and sectors subject to screening, the profile and origin of investors, investment thresholds, risk assessment criteria, institutional structure, procedures and procedural safeguards, sanctions, as well as full alignment with European Union legislation.

AmCham expresses its full readiness to contribute professional expertise to the drafting of a sustainable and balanced legal framework and to cooperate with the competent institutions in the preparation of a guiding document for the future law on the screening of foreign investments.

Thank you for your consideration. We remain at your disposal for any further technical or institutional discussions.

Respectfully submitted,

American Chamber of Commerce in Albania